

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-13/05

Prishtinë, më 15, 16 dhe 19 dhjetor 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 96 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Provimin e Jurisprudencës;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjuetinë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2006;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Veprihtarinë Botuese dhe Librin; 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionet e Kulturës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Arsimin dhe Aftësimin Privat;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të Drejtat dhe Liritë e Organizimit Sindikal;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit,
11. Shqyrtimi i propozimit për krijimin e Komisionit për siguri,
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Mahir Yagcilar, anëtarë të Kryesisë,
13. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Xhezair Murati për anëtar të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim euroatlantik
14. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit,

15. Rekomandimi i Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar Ora dhe

16. Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha.

•

Kryetari, në fillim të seancës, me një fjalim rasti përshëndeti lirimin e ishdeputetit të Kuvendit të Kosovës, Fatmir Limaj, si i pafajshëm, nga Gjykata e Hagës, i cili ishte i pranishëm në sallë.

Pastaj, kryetari ia dha fjalën ishdeputetit të Kuvendit të Kosovës.

Fatmir Limaj i falënderoj deputetët e Kuvendit për punën e bërë gjatë tri viteve, për miratimin e Rezultues për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran, si dhe për përkrahjen që i kishin dhënë deri sa ishte në paraburgim.

Ai kërkoi nga deputetët dhe nga të gjitha forcat politike në vend që të jenë bashkuar për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Pas fjalimit të Fatmir Limaj, kryetari dha pauzë gjysmë orësh, për t'ua mundësuar të gjithë deputetëve të përshëndeten me të.

•

Pas pauzës deputeti Bislim Hoti kontestoi deklaratimet e deputetit Numan Baliq për përfaqësimin e egjiptasëve të Kosovës.

Numan Baliq e kundërshtoi Bislim Hotin.

Ramë Buja kërkoi të diskutohet për mënyrën e shpenzimeve të buxhetit të Kosovës.

Kryetari tha se duhet të përgatitet një informatë për Kryesinë e Kuvendit lidhur me shpenzimet buxhetore, pastaj të vendoset për procedimin e saj.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që Kuvendit të mbajë seanca parlamentare për çdo javë, për t'i diskutuar çështjet që kanë ngritur më herët, kurse Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me grupet parlamentare duhet ta përgatitë kalendarin e seancave plenare.

Teutë Sahatçia, në emër të Grupit Parlamentar ORA, tha se e mbështetë kërkesën e Jakup Krasniqit, si dhe kërkoi që rendi i ditës për seancën e radhës të miratohet në fund të çdo seance plenare.

Gjergj Dedaj i informoi deputetët lidhur me formimin e Grupit Parlamentar për Integrim, si dhe kërkoi që anëtarët e këtij grupi të përfshihen në punën e komisioneve parlamentare dhe në Kryesinë e Kuvendit.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se distancohet nga akuzat publike, që nuk janë të argumentuara, në adresë të Kryesisë dhe të kryetarit të Kuvendit. Ai kërkoi nga Kryesia që ta përgatisë një raport për punën e saj dhe t'ia procedojë Kuvendit.

Gani Koci tha se duke pasur për bazë rëndësinë e Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2006, duhet t'i kushtohet një seancë e veçantë për shqyrtimin e tij.

Kryetari tha se do t'i kushtohet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Kryesia, duke pasur parasysh kohën e shkurt, ka propozuar që ky projektligj të kalojë me një shqyrtim, kurse Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar që të shqyrtohet në procedurë të rregullt parlamentare.

Pajtohem me kërkesën që shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës të jetë pika e parë e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Haki Shatri, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2006.

Në vazhdim ministri Shatri tha se

Buxheti i vitit 2006 bën ndërlidhjen e planifikimit të buxhetit me prioritetet e Qeverisë, si vijon:

Realizimi i standardeve për Kosovën; Zhvillimi i infrastrukturës si bazë për nxitjen e sektorit privat dhe për rritjen ekonomike; Rritjen e efektshmërisë së shpenzimeve qeveritare.

Brenda kufijve të shpenzimeve prej **700** milionë € sigurohet mbështetja e aktiviteteve kyçe për Kosovën, si: Diskutimi për statusin e Kosovës; Procesi i decentralizimit dhe bartja e përgjegjësisë nga fushat e rezervura tek institucionet vendore, përfshirë këtu themelimin e dy ministrive të reja

Të hyrat: Për vitin 2006 janë planifikuar të hyra të përgjithshme në shumë prej **656** milionë €. Kjo shumë përfshin edhe tarifatat nga shfrytëzimi i minierave, dhënien e licencës së operatorit të dytë të telefonisë mobile dhe taksën e ekstraprofit nga PTK.

Deficiti i vlerësuar për vitin 2006 prej **38** milionë € nuk kalon 3% të brutoproduktit vendor dhe është në linjë me udhëzimet e sugjeruara ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare.

Të hyrat buxhetore në këtë vit paraqesin 27% të bruto produktit vendor, e cila përqindje i përgjigjet nivelit ekonomik të Kosovës.

Në strukturën e të hyrave, të hyrat nga tatimet marrin pjesë me **84 %**, të hyrat **jotatimore 7.7 %**, të hyrat **vetanake të komunave 5.2 %** dhe të hyrat tjera **3.1 %**. Në të hyrat tatimore edhe më tutje vazhdojnë të **dominojnë të hyrat që realizohen në kufi me 77.1 %**.

Shpenzimet: Buxheti i vitit 2006 kufizon rritjen e faturës së pagave dhe të punësimit në sektorin publik. Fatura e përgjithshme e **pagave**, krahasuar me shpenzimet totale, është mbajtur në **28% të shpenzimeve të gjithmbarshme buxhetore**. Shpenzimet **kapitale** do të arrijnë në gjithsej **177 milionë** euro në vitin 2006. Kjo paraqet një **rritje prej 4%** në shpenzimet kapitale, krahasuar me planin e buxhetit 2005. Limitimi i **shpenzimeve buxhetore në 700 milionë €** paraqet një **shkurtim për 5 %** në krahasim me shpenzimet e lejuara me buxhetin e vitit 2005.

Megjithkëtë është përmirësuar struktura e shpenzimeve në favor të rritjes absolute të vëllimit të investimeve kapitale, është rritur fondi i pagave 201 milion €, subvencionet dhe transferet 168 milion €. Janë **zvogëluar kategoria "mallra e shërbime"** mesatarisht **për 10%** dhe rezervat nga 9 milion në 6 milion euro.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Shatri, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë edhe deputetët: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylja, Veton Surroi, Mahir jakxhillar, Naser Osmani, Gani Koci, Nazim Jashari, Bajram Rexhepi, Sabri Hamiti, Behxhet Brajshori, Gjergj Dedaj, Emrush Xhemajli, Mazlun Kumnova, Fatmir Rexhepi, Afrim Arzuallxhiu, Besa Gaxheri, Berat Luzha, Fatmire Mulhaxha, Sala Ahmeti, Ramadan Kelmendi, Safete Hadërgjonaj, Ragip Zekolli, Zef Morina, Mark Krasniqi, Genc Gorani, Bajrush Xhemajli, Jonuz Kastrati, Teutë Hadri-Ramadani, Fadil Kryeziu, Fetah Berisha, Hajredin Hyseni, Gazmend Muhaxheri, Fehmi Mujota, Sala Berisha-Shala, Xhevdet Neziraj, Selvije Halimi, Shaban Halimi, Hatixhe Hoxha, Xhevat Bislimi dhe Zahrije Isufi**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----48;
Kundër--- 28;
Abstenime- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojnë këtë projektligj me procedurë të përshpejtuar, brenda javës, dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 18:15 minuta.

•

Më 16 dhjetor 2005
Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Të pranishëm ishin 84deputetë.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** kërkoi nga deputetët t'i miratonin amendamentet që ai kishte propozuar, të cilat nuk i kishte mbështetur Komisioni për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale.

Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit për Çështje Gjqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, tha se ky komision i ka mbështetur amendamentet e deputetit Ramadan Kelmendi.

Ministrja **Melihate Tërmkoll**i, në emër të propozuesit të Projektligjit, kërkoi që të shtyhet miratimi i këtij projektligji në mënyrë që Komisioni Funkcional dhe Komisioni Legjislativ t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me amendamentet e propozuara nga deputeti Ramadan Kelmendi.

Deputeti **Fehmi Mujota** sqaroi qëndrimet e Komisionit Funkcional lidhur me amendamentet e propozuar në këtë projektligj, por e mbështeti kërkesën që dy komisionet t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur amendamentet e propozuara.

Alush Gashi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që komisioneve parlamentare t'u jepet kohë për t'i harmonizuar qëndrimet lidhur me amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këto

Përfundime:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës **shtyhet** për seancën e radhës.
2. Ngarkohen Komisioni për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale dhe Komisioni për Çështje Gjqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese t'i **harmonizojnë** qëndrimet lidhur me amendamentet e propozuara nga deputeti, Ramadan Kelmendi, për Projektligjin për provimin e jurisprudencës dhe t'ia paraqesin Kuvendit një raport të përbashkët.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjuetinë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 20, 21 dhe 22.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për gjuetinë.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri
Në vazhdim zëvendësministrja **Krasniqi**, shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.
Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministrja **Krasniqi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ramadan Musliu, Dritë Statovci, Mazllun Kumnova, Gencë Gorani, Xhezair Murati, Sanije Aliaj, Sabri Hamiti, Mark Krasniqi, Nexhat Rexha dhe Fetah Berisha**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 68;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet e kulturës

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri
Në vazhdim zëvendësministrja **Krasniqi**, shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.
Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministrja **Krasniqi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nimon Alimusaj, Sala Ahmeti, Mevlyde Dreshaj, Nuran Malta dhe Emrush Xhemajli**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 72;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për institucionet e kulturës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

Kryetari dha pauzë dreke.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Agim Veliu**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim ministri **Veliu**, shpjegoi materien, strukturën, objektivat, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Veliu**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ragip Zekolli, Enver Hoxha, Ymer Halimi, Gencë Gorani, Nuran Malta, Naxhije Doçi, Dritë Statovci, Gjylshene Berisha, Hajredin Hyseni, Agim Krasniqi, Remzije Nimani dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 41;
Kundër----- 31;
Abstenime-----3.

Të pranishëm në seancë ishin 72 deputetë.

Përshkak të mospërputhjes së numrit të votuesve me numrin e deputetëve që ishin të pranishëm në seancë, kryesuesi kërkoi që të përsëritet votimi.

Në ndërkohë seancën e kryeson **Nexhat DACI**, kryetar i Kuvendit, i cili pasi që u njoftua me rrjedhën e votimit propozoi që seanca të vazhdojë punimet më 19 dhjetor 2005.

Më 19 dhjetor 2005
Vazhdim i seancës

Të pranishëm ishin **81 deputetë**.

Kryetari e hodhi në rivotim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----28;
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin privat. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006

Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e arsyetoi raportin e këtij komisioni lidhur me amendamentet e propozuara për Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, tha se Qeveria i mbështetë amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Kryetari i hodhi në votë, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pas diskutimeve të deputetëve: **Nazim Jashari, Gani Koci, Hydajet Hyseni, Alush Gashi, Fatmire Mulhaxha, Fatmir Sejdiu, kryeministrit Bajram Kosumi dhe ministri Haki Shatri**, Kuvendi

V E N D O S I

Që shtojca e Projektbuxhetit për ART-në të shtyhet për seancën e radhës.

Në fund, kryetari e hodhi në votë Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----54;
Kundër-----23.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi Projektligjin për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Filharmoninë e Kosovës

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministrja **Angjelina Krasniqi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim zëvendësministrja **Krasniqi**, shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministrja **Krasniqi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Gjylshene Berisha, Sala Ahmeti, Mazlun Kumnova, Ferid Agani, Behxhet Brajshori, Fadil Kryeziu, Hydajet Hyseni dhe Kamber Kamberi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 67;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për Filharmoninë e Kosovës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim ministri Selmanaj, shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ramadan Kelmendi, Berat Luzha, Zylfije Hundozi, Teutë Sahatçia, Hysnija Beshkoviq, Flora Brovina, Sanije Alaj, Sala Berisha, Teutë Hadri dhe Bajrush Xhemajli**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 68;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Punë, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspektoratin e produkteve të ndërtimit

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Bujar Dugolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Dugolli**, shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Dugolli**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lutfi Zharku, Hatixhe Hoxha, Mahir Jakxhillar, Ymer Halimi, Teutë Sahatçia, Zylfije Hundozi, Milazim Haliti dhe Ibush Jonuzi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 6.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për inspektoratin e produkteve të ndërtimit.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim.

12. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për Siguri

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për përfundimin e Kryesisë lidhur me kërkesën e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë për formimin e Komisionit për Siguri.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë përfundim.

Pas diskutimeve të deputetëve: **Fadil Kryeziu, Gjylnaze Syla, Jakup Krasniqi, Ferid Agani dhe Xhevat Bislim**, Kuvendi

V E N D O S I

Formimi i Komisionit për Siguri shtyhet për seancën e radhës.

13. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Mahir Jakxhillar anëtar të Kryesisë së Kuvendit

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti **Mahir Yağcılar** emërohet anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, për periudhën njëvjeçare – dhjetor 2005 - nëntor 2006, në vend të anëtarit të deritanishëm, Xhezair Murati.

14. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Xhezair Murati anëtar të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euroatlantik

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti Xhezair Murati emërohet anëtar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euroatlantike, në vend të deputetit Mahir Yağcılar.

15. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit

Kuvendi, në mungesë të biografive për anëtarët e propozuar,

V E N D O S I

Ta shtyjë për seancën e radhës emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit

16. Rekomandimi i Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar Ora

Kryetari i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, **Hydajet Hyseni** e arsyetoi rekomandimin e këtij komisionit para deputetëve të Kuvendit.

17. Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigj pyetjes së deputetit Berat Luzha.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:50 minuta.

E hartoi

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat DACI**